



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

KOMUNA E PRISHTINËS
KRYETARI I KOMUNËS

14-020/04-69943/18, më 23. 03. 2018

Në bazë të dispozitave të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L -040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/04, qershor 2008), të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.02.2010, dhe të nenit 10 të Vendimit për kriteret dhe procedurën e ndarjes së subvencioneve, nr. 01 nr. 031-112404, dt. 12.05.2014, Kryetari i Komunës së Prishtinës merr këtë

V E N D I M

- I. Miratohet Vendimi për formimin e komisionit për përcaktimin e kriterëve në sektorin e bujqësisë, në këtë përbërje:
 1. Shkumbin Gashi, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë,
 2. Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave,
 3. Fexhri Hyseni, udhëheqës i Sektorit të bujqësisë,
 4. Merita Tolaj, zyrtare e lartë, prodhimtari bimore;
 5. Ahmet Musa, msc, mbrojtje e bimëve.
- II. Detyra e Komisionit është përcaktimi i kriterëve dhe mënyra e përkrahjes për secilën fushë në sektorin e bujqësisë, duke u bazuar në buxhetin e Komunës për vitin 2018.
- III. Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e marrjes së tij.

U dorëzohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Qendrës për shërbime me qytetarë,
- Në dosje.



KRYETARI I KOMUNËS
Shefqet Ahmeti